



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Zyra e Sekretarit të Përhershëm

Office of the Permanent Secretary

Kancelarija Stalnoq Sekretara

**Rekomandim nga Inspektorati i MMPH-së, për Drejtorin e Urbanizmit - Prishtinë
në bazë të reagimit të IQMQP-së të datës 02.11.2009 nr. 09/2192/4 .**

Inspektorati i MMPH-së ka shqyrtuar me kujdes reagimin e IQMQP-së të datës 02.11.2009 me Nr. 09-2192/4 ndaj përgjigjes Nr .09/2192/1 të datës 05.10.2009.

Inspektorati i MMPH – së ka shqyrtuar ankesën e IQMQP-së të datës 05.10.2009 me Nr.09-2192/1 dhe në lidhje me këtë me datën 16.10.2009 kemi inspektuar vendin e ngjarjes ku edhe është konstatuar se është duke u ndërtuar objekti individual banesor dhe afarist në rrugën “ Hajrullah Abdullahu “ nr. 33 , lagja Muhagjerve në Prishtinë (Bregu i Diellit) . Aktvendim për Leje Ndërtimi është lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit , Kadastrës dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Prishtinës 05 Nr.351-13664 të datës 10.07.2009.ndaj të cilit kanë ngritur shqetësimet e tyre IQMQP-së .

Gjatë inspektimit tonë në vendin e ngjarje me datë 16.10.2009 kemi konstatuar se punët ishin në vazhdimësi e sipër në fazën e realizimit të punëve të bodrumit dhe punët ishin duke u punuar në bazë të Lejes Urbanistike 05 Nr350-20440 të datës 26.09.2008 , dhe Lejes Ndërtimore 05 Nr.351-13664 të datës 10.07.2009 si dhe dokumentacionit teknik dhe pëlqimeve të nevojshme të cilat i paraprinë Lejes Ndërtimore .Investitorë të objektit janë vëllezërit Loxha ku Aktvendimi për Leje Ndërtimore është në emër të Mustafë , Nexhdet dhe Ali Loxha .

Por gjatë riinspektimit tonë rutinorë të objektit të lartpërmendur me datë 06.11.2009 kemi konstatuar se punët ndërtimore në objekt janë në fazën e përdheses dhe këtu kemi vërejtur se ka shkelje ligjore d.m.th. tejkalime të gabaritetit të përdheses sipas Lejes Urbanistike dhe kushteve urbanistike si dhe shkelje të kushteve të aktvendimit të Lejes Ndërtimore nr 351-13664 të datës 10.07.2009.


Inspektorati i Ndërtimit dhe Planifikimit i MMPH-së rekomandon që :

Inspektorati i Komunës së Prishtinës të inspektoj objektin e lartpërmendur dhe të reagoj në mënyrë urgjente në bazë të kompetencave të veta ligjore sipas Ligjit të Ndërtimit Nr.2004/15 , të marë masat e nevojshme ligjore në zbatimin e kushteve urbanistike të cekura në Lejen Urbanistike Nr. 350-20440 të datës 26.09.2008 si dhe kushtet të Lejes Ndërtimore Nr.351-13664 të datës 10.07.2009 . të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës .

Ne konstatojmë se shqetësimet e qytetarëve janë të arsyeshme për rastin e lartpërmendur dhe Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës e cila ka lëshuar Lejeve Urbanistike dhe Lejeve Ndërtimore është kompetente dhe përgjegjëse e drejtpërdrejtë në inspektimin dhe zbatimin e ligjit . Në lidhje me këtë Inspektorati i Ndërtimit i MMPH-së do të ushtroj mbikëqyrje të mëtejme inspektive në lidhje me objektin e lartpërmendur dhe me zbatimin e ligjshmërisë nga Inspektorati Komunal i Komunës së Prishtinës .

06.11.2009
Prishtinë

Inspektori i N. dhe P.H. i MMPH-së


Refik Rexhepaj